



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
VLORË

Nr.148 Regj. Them
Datë 17.04.2013

Nr. 148 Vendimi
Datë 22.04.2013

V E N D I M
"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë e përbërë nga :

GJYQTAR: ERVIN TRASHI

Asistuar nga sekretare séance *Lorena Grabova*, sot më datë 22.04.2013 përfundoi së shqyrtuari në seancë gjyqësore me dyer të hapura kërkesën penale që i përket:

Kërkues: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, përfaqësuar në gjykim nga Prokurorë [redacted]

Person i interesuar: [redacted] i biri i Feti dhe Nazmije, i datëlindjes 05.12.1976, lindur dhe banues në Vlorë, identifikuar me letërnjoftimin nr.

Objekti: Konfiskimin e mjetit lundrues tip gomone, që i përket shtetasit [redacted] të sekuestruar me procesverbalin e datës 07.04.2013 nga oficeri i policisë gjyqësore [redacted]

Baza Ligjore: Neni 23/3 Ligji Nr. 8663 datë 18.09.2000 "Për regjistrimin, klasifikimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor, me tonazh nën 20 NT".

Gjykata, në përfundim të gjykimit pasi administroi provat shkresore dëgjoi palët në pretendimet përfundimtare, ku prokurorë Vojsava Starova kërkoj pranimin e kërkesës, ndërsa personi i interesuar [redacted] kërkoj rrëzimin e saj.

Gjykata pasi shqyrtoi dhe bisedoi çështjen në tërësi:

V E R E N

Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, më datë 17.04.2013 ora 13.45, është sjellë për gjykim, pranë kësaj gjykate, kërkesa për konfiskimin e mjetit lundrues tip gomone, që i përket shtetasit [redacted] të sekuestruar me procesverbalin e datës 07.04.2013 nga oficeri i policisë gjyqësore [redacted]

Në shqyrtimin gjyqësor, bazuar mbi provat shkresore të paraqitura nga pala kërkuese rezultoi se:

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, mbi bazën e materialit të ardhur nga Drejtoria Rajonale e Kufirit dhe Migracionit Vlorë, ka regjistruar procedimin penal Nr. 224 viti 2013 për veprën penale të parashikuar nga neni 23/1 të Ligjit Nr. 8663 datë 18.09.2000 "Për regjistrimin, klasifikimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor, me tonazh nën 20 NT" aktet e të cilit janë në ngarkim të shtetasit [redacted]

Nga materialet referuese ka rezultuar se në datë 07.04.2013 në orën 23.00, shërbimet e policisë së Komisarariatit të Policisë Vlorë, kanë ushtruar kontroll në banesën e shtetasit [REDAKTUAR] në fshatin Radhimë Vlorë. Gjatë kontrollit të ushtuar kanë gjetur një mjet lundrues tip gomone. Nga deklaratimet e shtetasit [REDAKTUAR] ka rezultuar se ky mjet i përket nipit të tij [REDAKTUAR].

Në këto kushte oficeri i policisë gjyqësore, i Drejtorisë së Policisë Qarku Vlorë, Sektori kundër Narkotikëve dhe Trafiqeve [REDAKTUAR] duke konstatuar mungesën e dokumentacionit nga mbajtësit e këtij mjeti, ka kryer sekuestrimin sendit: "Mjeti lundrues tip Gomone, me ngjyrë gri, pa mbishkrim, i pamatrikulluar, me gjatësi 5 metra dhe gjerësi 1.8 metër, me një motor tip ENVIRUDE E60DPL, fuqi motorrike 44.00 kuv, i vendosur në një karel transportues."

Nga verifikimet e kryera më pas ka rezultuar se, shtetasi [REDAKTUAR] mjetin e sekuestruar e ka blerë në datë 06.04.2013 nga shtetasi [REDAKTUAR], i cili ushtron aktivitetet të prodhimit, riparimit dhe tregtimit të mjeteve lundruese, me seli në Vlorë, emri tregtar [REDAKTUAR] shp.k. dhe Nipt J 96714219 F. Blerja e këtij mjeti lundrues është kryer kundrejt faturës tatimore të shitjes nr serie 05538302 datë 06.04.2013.

Për sa më sipër, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë pretendon se shtetasi [REDAKTUAR] ka kryer shkelje të nenit 12 të Ligjit Nr. 8663 datë 18.09.2000, pasi nuk ka deklaruar me shkrim brënda 24 orëve nga zotërimi apo mbajtja e këtij mjeti lundrues, në policinë kufitare të territorit që është Drejtoria Rajonale e Kufirit dhe Migracionit Vlorë. Prokuroria pretendon se në zbatim të nenit 23/1 të ligjit të sipërcituar, është përcaktuar se mosrespektimi i nenit 12 të këtij ligji, përbën kundërvajtje penale dhe shoqërohet me sekuestrimin e mjetit lundrues nga oficeri i policisë gjyqësore.

Nga shqyrtimi i akteve shkresore të administruara në dosje, Gjykata vlerëson se kërkesa e Prokurorisë duhet të rrëzohet për këto arsye:

Gjykata merr në analizë ligjin Nr. 8663 datë 18.09.2000 "Për regjistrimin, klasifikimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor, me tonazh nën 20 NT"¹ dhe nenet 270-276 të Kodit të Procedurës Penale.

Në neni 5 të Ligjit 8663/2000 përcaktohet detyrimi i përgjithshëm i mjeteve lundruese, i cili në çdo rast është matrikullimi i tyre në kapitenerinë e portit si dhe regjistrimi në zyrën e policisë kufitare, përgjegjëse për territorin.

Neni 6 i ligjit 8663/2000 ka përcaktuar procedurën e matrikullimit dhe lëshimit të lejes së lundrimit. Në pikën 1 të këtij neni përcaktohet: "Kërkesa për matrikullim duhet të paraqitet nga pronari ose nga bashkëpronarët e mjetit lundrues brenda pesë ditëve nga fitimi i së drejtës të pronësisë mbi mjetin lundrues dhe duhet të përcaktojë qëllimin e përdorimit të mjetit, duke i bashkëlidhur dokumentacionin e lëshuar nga Regjistri Detar Shqiptar."

Neni 7 i ligjit 8663/2000 ka përcaktuar procedurën për regjistrimin në zyrën e policisë. Në pikën 1 të këtij neni përcaktohet: "Kërkesa për regjistrim nga pronari ose nga bashkëpronarët e mjetit lundrues duhet t'i paraqitet zyrës së policisë kufitare, përgjegjëse për territorin, brenda pesë ditëve nga lëshimi i lejes së lundrimit."

¹Më poshtë do të citohet ligj 8663/2000

Neni 9 i ligjit 8663/2000 ka përcaktuar se brenda 5 ditëve nga kryerja e regjistrimit, zyra e policisë kufitare, i lëshon pronarit çertifikatën e përdorimit të mjetit lundrues.

Nga interpretimi literal i këtyre dispozitave rezulton se pronari i një mjeti lundrues duhet që brenda 5 ditëve nga momenti i blerjes së mjetit, të paraqitet në Kapitenerinë e Portit me qëllim matrikullimin dhe pajisjen me lejen e lundrimit. Brenda 5 ditëve nga pajisja me leje lundrimi, pronari i mjetit lundrues duhet të paraqesë kërkesën për regjistrimin e mjetit lundrues në zyrën e policisë kufitare përgjegjëse për territorin. Kjo e fundit brenda 5 ditëve nga kryerja e regjistrimit, i lëshon pronarit çertifikatën e përdorimit të mjetit lundrues.

Në pjesën e tretë të këtij ligji neni 11 i tij ka rregulluar importimin e mjeteve lundruese, sipas të cilit përcaktohet: "Cilido që importon një mjet lundrues, objekt të këtij ligji, përveç ndjekjes së procedurave doganore të parashikuara, duhet të bëjë edhe deklarinimin me shkrim, brenda njëzet e katër orëve nga mbërritja e mjetit, në zyrën e policisë kufitare, kompetente për territorin, duke shënuar vendqëndrimin e vet, vendbazimin e mjetit dhe gjeneralitetet e pronarit ose të bashkëpronarëve.

Ndërsa neni 12 i ligjit 8663/2000 ka përcaktuar rastin kur mjeti lundrues është matrikulluar dhe regjistruar, por ndryshon vendbazimi i përhershëm i mjetit. Në këtë rast personi që zotëron ose mban, me çfarëdolloj titulli, një mjet lundrues ose pjesë të tij, duhet të bëjë deklarinimin me shkrim, brenda njëzet e katër orëve nga marrja në zotërim ose në mbajtje, në zyrën e policisë kufitare, përgjegjëse për territorin.

Në pjesën e shtatë të këtij ligji të titulluar "Sanksionet" janë parashikuar edhe shkeljet përkatëse që përbëjnë kundërvajtje penale. Në këtë ligj janë parashikuar 12 vepra penale, të cilat kanë specifikat e tyre, përsa u përket anës objektive dhe subjektit shkelës.

Saktësisht janë të përcaktuara këto vepra penale. Neni 19 "Regjistrimi dhe lëshimi i paligjshëm i çertifikatës së përdorimit" Neni 20 "Mospasja e dokumenteve gjatë lundrimit" Neni 21 "Refuzimi për paraqitjen e dokumenteve" Neni 22 "Mosbërja e deklarinimit të importimit" Neni 23 "Mosdeklarimi i zotërimit ose i mbajtjes" Neni 24 "Mungesa e matrikullimit ose e regjistrimit" Neni 25 "Ndryshimi ose falsifikimi i karakteristikave të mjetit lundrues" Neni 26 "Përgjegjësia e fabrikave dhe e kantierëve detare" Neni 27 "Refuzimi i paraqitjes së regjistrave" Neni 28 "Mosdeklarimi i ndryshimeve" Neni 29 "Zhvendosja ose përdorimi i mjetit pa autorizim" Neni 30 "Tejkalimi i numrit të personave që transportohen"

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë pretendon se shtetasi [redacted] ka kryer veprën penale të "Mosdeklarimi i zotërimit apo mbajtjes" parashikuar nga neni 23 i këtij ligji. Në këtë dispozitë është përcaktuar se:

"1. Mosdeklarimi i zotërimit ose i mbajtjes, siç parashikohet në nenin 12, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga 100.000 (njëqind mijë) deri në 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, si dhe me konfiskimin e mjetit lundrues.

2. Oficeri ose agjenti i policisë kufitare, që ka verifikuar shkeljen, sekuestron mjetin lundrues dhe respekton procedurën e parashikuar në pikat 3, 4, 5 e 6 të nenit 31.

3. Gjykata, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e masës së sekuestrimit, vendos për konfiskimin e mjetit lundrues."

Pikë së pari:

Gjykata vlerëson se shtetasi [redacted] nuk ka konsumuar kundërvajtjen penale të mosdeklarimit të zotërimit apo mbajtjes së mjetit lundrues. Kjo veprë penale nga ana objektive konsiderohet e konsumuar në rastin kur mjeti lundrues është matrikulluar dhe regjistruar, por ndryshon vendbazimi i përhershëm i mjetit. Në këtë rast personi që

zotëron ose mban, me çfarëdolloj titulli, një mjet lundrues ose pjesë të tij, duhet të bëj deklarinimin me shkrim, brenda 24 orëve nga marrja në zotërim ose në mbajtje, në zyrën e policisë kufitare, përgjegjëse për territorin.

Nëse shtetasi [redacted] do të përgjigjej për ndonjë kundërvajtje penale do të ishte ajo e parashikuar nga Neni 24 i ligjit 8663/2000 "Mungesa e matrikullimit ose e regjistrimit", por edhe në këtë rast, sipas parashikimeve të neneve 6 dhe 7 të këtij ligji, shkelësi mban përgjegjësi vetëm pas kalimit të afatit 5 ditor nga fitimi i së drejtës të pronësisë mbi mjetin lundrues.

Nga aktet shkresore të administruara për rastin konkret ka rezultuar se shtetasi [redacted] e ka blerë mjetin nëpërmjet faturës tatimore për shitje në datë 06.04.2013 dhe sekuestrimi i mjetit është kryer në datë 07.04.2013, pra vetëm një ditë më pas. Nga shtetasi [redacted] është deklaruar se mungesa e kryerjes së procedurave përkatëse ka të bëjë edhe me faktin se mjeti lundrues është blerë ditën e shtunë, ndërsa sekuestrimi është kryer ditën e djelë. Pra ka rezultuar se nuk ka kaluar afati 5 ditor sipas nenit 6 të ligjit 8663/2000, për të konstatuar shkeljen përkatëse.

Së dyti: Në analizë të gjykatës është edhe fakti se konfiskimi i mjetit është parashikuar në këtë dispozitë njëkohësisht, si sanksion ndaj kundërvajtjes penale të kryer, por edhe si masë sigurimi pasuror ndaj subjektit shkelës, kërkesë kjo e hetimeve paraprake.

Gjykata konstaton se Kodi i Procedurës Penale ka përcaktuar se masat e sigurimit pasuror janë ndarë në sekuestro konservative dhe sekuestro preventive. Neni 270 i K.Pr.Penale ka përcaktuar kushtet e marrjes së sekuestros konservative, sipas të cilës përcaktohet: "*Kur ka arsye të bazuara për të menduar se nuk ka garanci për pagimin e dënimit me gjobë, të shpenzimeve të procedimit dhe të çdo detyrimi ndaj pasurisë së shtetit, prokurori kërkon sekuestron konservative të pasurisë së luajtshme ose të paluajtshme të të pandehurit ose të shumave a sendeve që të tjerët i detyrohen atij, në caqë që ligji lejon sekuestrimin e tyre.*"

Neni 274 i K.Pr.Penale përcakton objektin e sekuestros preventive sipas të cilit: "*Kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, me kërkesën e prokurorit, gjykata kompetente urdhëron sekuestrimin e tij me vendim të arsyetuar.*"

Në analizë të dispozitave të sipërcituara si edhe të nenit 275 të K.Pr.Penale, rezulton se konfiskimi jepet vetëm me vendim përfundimtar, kur sendi ka shërbyer ose ishte destinuar për të kryer një veprë penale ose ka qënë prodhim apo përfitim nga vepra penale.

Nga analiza e mësipërme, gjykata vlerëson se konfiskimi i mjetit lundrues i parashikuar në nenin 23 të ligjit 8663/2000, duhet vlerësuar si sanksion ndaj veprës penale dhe jo si masë në mbështetje të hetimit. Si e tillë për konfiskimin gjykata duhet të shprehet vetëm me vendim përfundimtar të gjykimit të çështjes penale.

Së treti: përsa i përket vleftësimit të sekuestros së datës 07.04.2013 të kryer prej oficerit të policisë gjyqësore, gjykata vlerëson se në zbatim të nenit 23/2 marrja e masës për sekuestrimin e mjetit duhet të respektojë procedurën e parashikuar nga neni 31 të ligjit 8663/2000.

Sipas përcakimve të nenit 31 të ligjit 8663/2000, rezulton se oficeri i policisë gjyqësore i zyrës së policisë kufitare, me vendim të gjykatës, kontrollon në vënde ku ka të dhëna të

bazuara se fshihen ose mbahen në mënyrë të paligjshme mjete lundruese, në kundërshtim me nenet 11, 12, 17, dhe 18 të këtij ligji. Oficeri mund të veprojë me nismën e vetë vetëm në rastin e gjëndjes së flagrancës.

Procesverbali i kontrollit dhe sekuestrimit të mjetit lundrues shërben si provë e veprës penale. Ndërkohë procesverbali hartohet në tre kopje, njëra i jepet të interesuarit, tjetra i dërgohet prokurorit, ndërsa një kopje tjetër arkivohet në aket e zyrës së policisë kufitare. Oficeri i policisë kufitare në zbatim të pikës 5 të këtij neni është i detyruar të bëjë me dije personin e interesuar, përpara fillimit të veprimeve, se mund të kërkojë mbrojtjen me një avokat. Ky procesverbal i dërgohet prokurorit brënda 48 orëve, i cili brënda 48 orëve në vijim vlerëson kontrollin.

Nga aket e dosjes hetimore ka rezultuar se nuk janë respektuar detyrimet e përcaktuara nga neni i sipërcituar. Pikë së pari gjykata vlerëson se rregulli është që kontrolli në rastin e një shkelje të tillë duhet të kryhet mbi bazën e një autorizimi të dhënë nga vendimi gjyqësor.

Nga ana e prokurorisë nuk u arsyetuan se cilat ishin arsyet e ngutshëmërisë për të cilën nuk mund të pritej vendimi i gjykatës për lejimin e kontrollit. Përrjashtëmish kontrolli mund të kryhet me nismën e oficerëve të policisë, por duhet të ekzistojnë kushtet e flagrancës, të cilat nuk rezultuan të provuara në një rast të tillë.

Nga procesverbali i kontrollit dhe vendim i sekuestrimit të sendit të datës 07.04.2013 ora 23.00, nuk rezulton që shkelësi të jetë bërë me dije, përpara fillimit të veprimeve nga ana e oficerit të policisë, mbi të drejtën e tij për t'u mbrojtur me avokat.

Gjithashtu ka rezultuar se procesverbali i kontrollit mbi bazën e të cilit është marrë edhe vendimi i sekuestrimit të sendit nuk është paraqitur në prokurori brënda afatit 48 orë të parashikuar nga pika 6 e nenit 31 të ligjit 8663/2000.

Nga aket në dosje rezulton se materiali është protokolluar në prokurori nr 3259 datë 11.04.2013, pra në tejkalim të afatit të përcaktuar në ligj. Duke qënë se kontrolli është kryer në datë 07.04.2013, atëherë afati maksimal do të ishte data 09.04.2013.

Ka rezultuar gjithashtu e provuar se vendimi i kontrollit mbi bazën e të cilit është marrë edhe vendimi i sekuestrimit të sendit, mjetit lundrues në pronësi të shtetasit [redacted] nuk është vlerësuar ligjshmëria prej prokurorit, si një kërkesë kjo e parashikuar nga pika 6 e nenit 31 të ligjit 8663/2000.

Gjykata duke vlerësuar se policia kufitare ka vepruar në kundërshtim me përcakimet e nenit 31 të Ligjit 8663/2000, vlerëson të paligjshëm sekuestrimin e mjetit lundrues tip Gomone, me ngjyrë gri, pa mbishkrim, i pamatrikulluar, me gjatësi 5 metra dhe gjerësi 1.8 metër, me një motor tip ENVIRUDE E60DPL, fuqi motorrike 44.00 kvv, në pronësi të shtetasit [redacted].

PËR KËTO ARSYE

Gjykata mbështetur në Ligjin Nr. 8663 datë 18.09.2000 "Për regjistrimin, klasifikimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor, me tonazh nën 20 NT".

VENDOSI

1. Rrëzimin e kërkesë së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me objekt konfiskimin e mjetit lundrues tip gomone, që i përket shtetasit [redacted] të sekuestruar me procesverbalin e datës 07.04.2013 nga oficeri i policisë gjyqësore [redacted]
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën e Apelit Vlorë, brenda 10 ditëve, nga e nesërmeja e shpalljes së vendimit.

U shpall, sot datë 22.04.2013 në Vlorë.

GJYQTAR

ERVIN TRASHI



Vendimi mori forme te prere me vendimin nr.154 date 29.05.2013 te Gjykatës se Apelit Vlore qe ka vendosur:

- Lënien ne fuqi te vendimit nr.227 date 22.04.2013 te Gjykatës se Shkalles se Pare Vlore.

KANCELARE
Irma DHIMITRIADHI

